

KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES


Nr. 13, datë 09.04.2021

**Për caktimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k dhe “Deloitte Albania” sh.p.k, si audituesë të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për vitet financiare 2021 - 2024**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 44, pika 2, të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 10, pika 1, shkronja (ç) të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të nenit 7, pika 6, të nenit 18 të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 5 të Rregullores të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020 “Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Të caktojë bashkimin e operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k dhe “Deloitte Albania” sh.p.k, si audituesë të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për vitet financiare 2021 - 2024.
2. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e kontratës me bashkimin e operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k dhe “Deloitte Albania” sh.p.k.



## KËSHILLI DREJTUES

3. Të caktojë Znj. Nexhmije Çela për ndjekjen e zbatimit të kushteve të kontratës ndërmjet Agjencisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k dhe “Deloitte Albania” sh.p.k.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**